



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në bazë të nenit 47, paragrafit (1), pika 6), dhe në pajtim me nenin 19, paragrafi (1), pika 2) i Ligjit për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/2010), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

V E N D I M

për kredi brenda ditës

1. Me këtë vendim rregullohen kushtet e miratimit të kredisë për kryerjen e pandërprerë të transaksioneve të pagesave të bankave (në tekstin vijues: kredi brenda ditës).
2. Të drejtën e kredisë brenda ditës kanë të gjitha bankat dhe filialet e bankave të huaja (në tekstin vijues: bankat).
3. Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë (në tekstin vijues: Banka Popullore) miraton kredi brenda ditës bankave përmes lidhjes së transaksioneve repo me afat maturimi në të njejtën ditë.

Për kredinë e miratuar brenda ditës Banka Popullore nuk ngarkon interes.

4. Si instrumente për sigurimin e kredisë brenda ditës përdoren letrat me vlerë të shënuara në Listën e letrave me vlerë për zbatimin e operacioneve monetare.
5. Kredia brenda ditës miratohet me kërkesë të bankës.

Banka Popullore ka të drejtë të kufizojë miratimin ose të refuzojë kërkesën për kredi brenda ditës.

6. Kërkesa për lidhjen e kredisë brenda ditës përmban këto elemente:

- shumën monetare në denarë;
- shenjë e letrave me vlerë (ISIN, përkatësisht shenjë e ankandit);
- shuma nominale e letrave me vlerë;
- llogari në Sistemin e Pagesave Ndërbankare të Maqedonisë (në tekstin vijues: MIPS);
- llogari e letrave me vlerë në Depozitën Qendrore të Letrave me Vlerë ShA Shkup, nëse përdoren letrat me vlerë të regjistruara në këtë institucion.

Kërkesën për kredi brenda ditës banka e dorëzon në Bankën Popullore përmes Sistemit Elektronik të Bankës Popullore për operacionet e tregut (në tekstin vijues: Sistemi Elektronik), gjatë çdo dite pune, jo më vonë se në momentin kur MIPS-i ndalon marrjen e mesazheve për transferimin e mjeteve nga bartësit e transaksioneve të pagesave për klientët e tyre, sipas planit afatshkurtër të MIPS-it dhe është i parevokueshëm.

7. Për kredinë e miratuar brenda ditës nëpërmjet Sistemit Elektronik përgatitet tiket elektronik në pajtim me Marrëveshjen e Përgjithshme Repo.



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

8. Në rast të problemeve teknike gjatë përdorimit të Sistemit Elektronik, banka mund ta dorëzojë kërkesën në Bankën Popullore me telefaks ose me mënyrë tjetër të njoftimit me shkrim. Banka Popullore e njofton bankën për kredinë e miratuar brenda ditës me telefon, telefaks ose mënyrë tjetër të njoftimit.
9. Banka është e detyruar të kthejë kredinë brenda ditës më së voni në momentin kur MIPS ndalon marrjen e mesazheve për transferimin e mjeteve nga mbajtësit e transaksioneve të pagesave për klientët e tyre.

Nëse banka nuk e kthen kredinë brenda ditës në afatin e caktuar, mund të paraqesë kërkesë për konvertimin e kredisë brenda ditës në kredi të disponueshme njëditore në pajtim me Vendimin për kredinë e disponueshme njëditore.
10. Nëse banka nuk e kthen kredinë brenda ditës dhe nuk paraqet kërkesë për konvertimin e kredisë brenda ditës në kredi të disponueshme njëditore, Banka Popullore e paguan kredinë brenda ditës dhe të gjitha pretendimet në bazë të kreditit me përfshirje të plotë të instrumenteve të sigurimit.
11. Shlyerja e kredisë brenda ditës kryhet në bazë të elementeve të shënuara në përfundim dhe në pajtim me Rregullat për mënyrën dhe procedurën e tregtimit dhe shlyerjes së transaksioneve me letrat me vlerë në tregjet përmes sportelit, Standardi për qëllimin dhe formati i mesazheve MT 199 në sistemin e kryqëzimit, Standardi për qëllimin dhe formati i mesazheve në MIPS dhe Udhëzimi për shlyerjen e transaksioneve me bono thesari të emituara.
12. Ky vendim hyn në fuqi me ditën e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".
13. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi pushon të vlej Vendimi për kredi brenda ditës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 84/2005).

V.nr.02-15/III-13/2011
31.3.2011
Shkup

Guvernatori
dhe kryesuesi
i Këshillit
të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë
м-р Петар Гошев